



REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilimeno/Prodato Received/Delivery	28.12.2022	viti god year	2
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHC/K	8546/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1062/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti -kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër Anr.1062/2022 të datës 29.11.2022 të parashtruar nga ankuesi [] përmes postës elektronike E-maili: ankesa.kpmschck@rks-gov.net, kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "*masë disiplinore-Vërejtje*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa numër A.nr.1062/2022 e datës 29.11.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. **ANULOHET** Vendimi i datës 27.10.222 me numër protokollit 090 i nxjerrë nga Drejtori i Qendrës Korrektuese në Lipjan, për shqiptimin e masës disiplinore "*Vërejtje*".
- III. **Obligohet** Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Zyrën e Kryeministrit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të largoj nga dosja personale e nëpunësit civil [] si dhe regjistri përkatës masën disiplinore të anuluar si në pikën II.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ankuesi i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, në pozitën Mbikëqyrës i lartë në Qendrën Korrektuese në Lipjan sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Kontratës së punës të datës 09.03.2020, të cilit me datë 27.10.2022 Drejtori i Qendrës Korrektuese Lipjan, i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje", në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankuesit, numër protokollit 090, me dyshimin se ankuesi ka bërë shkelje të lehtë disiplinore të përcaktuar në bazë të nenit 46 paragrafin 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe nenit 58 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Kundër masës disiplinore "Vërejtje" të datës 27.10.2022 me nr. protokollit 090, ankuesi ka parashtruar ankesë me datë 29.11.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil e regjistruar me numër A.nr.1062/2022, përmes postës elektronike, me pretendimin ankimor se "Vërejtja" i është shqiptuar pa bazë ligjore dhe pa vërtetuar gjendjen faktike dhe juridike, duke propozuar që ti aprovohet ankesa dhe të anulohet vërejtja e datës 27.10.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 01.12.2022 e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues të Kosovës. ndërsa kjo e fundit me datë 15.12.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollit 8136/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën e datës 29.11.2022 me numër protokollit 7444/2022, e parashtruar përmes E-mail të datës 29.11.2022, ankesa.kpmshck@rks-gov.net, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Vendimi -Vërejtja me shkrim me numër protokollit 090 i datës 27.10.2022 i nxjerrë nga Drejtori i Qendrës Korrektuese në Lipjan; Vendimi i datës 27.10.2022 me numër protokollit 090 i nxjerrë nga Drejtori i Qendrës Korrektuese në Lipjan, për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje"; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 01.12.2022 me numër protokollit 7532/2022; Përgjigje në ankesë e datës 15.12.2022 nga organi i punësimit me numër protokollit 8136/2022 bashkë me shkresat e lëndës; Ndryshimi dhe Plotësimit i Kontratës i datës 11.03.2020; Kontratë për kohë të pacaktuar; Hyrja-dalja e stafit në institucion; Hyrja - dalja në institucion e datës 24/25.10.2022; Deklaratë e datës 21.10.2022; Vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 08.01.2022; Vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2020 i datës 05.01.2021; E-mail zyrtar i datës 20.12.2022 dhe Udhëzim Administrativ MD-Nr.02/2022 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, Kontrollimi i së Kaluarës së tyre, Periudha Provuese dhe Promovimi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Drejtori i Qendrës Korrektuese në Lipjan, ndaj ankuesit Naser Fazliu i cili mbanë pozitën : "Mbikëqyrës i Lartë në Qendrën Korrektuese në Lipjan ", me datë 27.10.2022 i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje ", me dyshimin se i njëjti ka bërë shkelje të lehtë të detyrave të punës duke mos respektuar orarin e punës, nga se me datë 20.10.2022, gjatë hyrje -daljeve nuk i ka përmbushur

detyrat e punës, duke mos e mbajtur në mënyrë të rregullt procedurat e nënshkrimit dhe ardhjes me kohë në punë të Zyrtarëve të tjerë në Qendrën Edukuese Korrektuese Lipjan.

Ankuesi në deklaratën e dhënë me datën 21.10.2022 ka kërkuar falje gjatë sqarimit të rastit se nuk e e ka bërë me qëllim por nga pakujdesia.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se shqiptimi i masës disiplinore "Vërejtje", nga Drejtori i Qendrës Korrektuese në Lipjan, përmban shkelje të dispozitave procedurale duke pretenduar se vendimi i datës 27.10.2022 në është shqiptuar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, duke i propozuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, që ti aprovohet ankesa si e bazuar dhe të anulohet "Vërejtja" e datës 27.10.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave sa i përket kësaj çështje ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht kapitullin IV, lidhur me Disiplinën në Shërbim Civilë, si dhe Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, me të cilën është rregulluar në mënyrë specifike procedura dhe masat disiplinore për nëpunësit civil. Ndërsa në kuptim të kompetencës për iniciimin e procedurës disiplinore dhe shqiptimin e masave disiplinore, Kolegji ju referua nenit 47 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin shprehimisht është përcaktuar se: *1.Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil, ndërlidhur me këtë neni 48 paragrafi 1 i po këtij ligji ka përcaktuar se: 1.Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë "* dhe në këtë kuptim kolegji konstaton se vendimi i Drejtorit të Qendrës Korrektuese në Lipjan për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje", bie ndeshë edhe me dispozitat e nenit 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"1.Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë"*, e mbi këto baza ligjore të specifikuara më lartë konstatohet fakti se Drejtori i Qendrës Korrektuese në Lipjan nuk është Mbikëqyrës i Drejtpërdrejtë i ankuesit dhe mbi këto baza ligjore nuk ka pasur kompetencë për të shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore "Vërejtje". Po ashtu edhe pretendimi ankimor i ankuesit i cili e konteston vendimin e Drejtorit të Qendrës Korrektuese në Lipjan ku thuhet se është Zëvendësues i Udhëheqësit për Siguri dhe Operativë në Qendrën Edukuese Korrektuese në Lipjan është i bazuar sepse ankuesi nuk ka asnjë vendim që ushtron një pozitë të tillë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, administrimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, si dhe konstatimeve të dhëna në arsyetimin e këtij vendimi si më lartë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, ndërsa Drejtori i Qendrës Korrektuese në Lipjan me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Vërejtje" ndaj ankuesit kishte vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit material ngase nuk kishte kompetencë t'i shqiptojë masë ankuesit për shkak se i njëjti nuk është Udhëheqës apo Mbikëqyrës i Drejtpërdrejtë i ankuesit, ashtu që Vendimi me numër protokollit 090 i datës 27.10.2022, poashtu është nxjerr në



kundërshtim edhe me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase arsyetimi i të njëjtit ishte dukshëm i pamjaftueshëm apo i barabartë me mungesën e tij, andaj mbi bazën e konstatimeve të dhëna, konstatohet fakti se Vendimi i potencuar më lartë është vendim i paligjshëm siç përcaktohet me nenin 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative: "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material, dhe si i tillë ky vendim është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa ankesa e ankuesit është aprovuar si e bazuar për shkaqet e dhëna në arsyetimin e këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.1062/2022, datë 28/12/2022.

Sabile Avdyli



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI



Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

